

MBRETNIJA SHQIPTARE
PREFEKTURA E ELBASANIT

NR. 219/13 Res.

Elbasan më 3/XII/1942

P. T.
MINISTRISË SE P. TE MBRENDESHME
(Zyres Politike)

T i r a n e

Landa:

Mbi ditën e festës

Gjegjë urdhnit teligrafik nr. 1083/35 datë 2/XII/
1942.XXI

Me masat e marruna nga organet e sigurimit publik
qyshme 27 të mujit të kaluem ju dha me kuptue popullit se kjo Pre-
fekturë ishte e vendosun me festue kremen e Flamurit me solemnitet
dhe se nuk do të lejonte asnjë akt të pa hieshem në kundërshtim me
programin/ Përveç fuqisë së karabinierisë e agjentave të kuesturës
të repartëve të milicisë kemi në dispozicion edhe një kompani ka-
qjatorësh.

Siç duket studentët të frymzuem nga përmbajtja e
deklarates së hartueme në Tiranë prej Komitetit të përgjithshëm Na-
cional Qlirimtar dhe tue pasë bindje se çdo nisitive e tyre në kun-
dërshtim me programin do t'iu sillte dëm kanë preferue që ditën e
festës të mos paraqiten fare në shkolle e bile as nuk kanë dale at
dite prej shtëpie.

Drejtori i Normales, i marrun vesh me profesorë,
na kishte dhënë premtimin se ditën e festës do të paraqitej në orën
e caktueme bashkë me studentët të cilët ishin keshillue më u sjelle
mire dhe mos me provokue asnjë incident.

Ka qenë dhe asht gjithnjë kujdesi ynë me identi-
fikue dhe me arrestue auctorët që kanë frymzue studentat mos me ma-
rrë pjesë ditën e festës.

Në rastin e një rezultati pozitiv kemi me ju vë
në korent me një herë.

Nderime

Zav. Prefekti

Marrë nga kartoteka e historisë ushtarake nr. 1641